



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA E PARANDALIMIT TË  
KRIMEVE TË TË MITURVE DHE TË  
RINJVE

SHOQATA E AVOKATËVE  
PENALISTË TË SHQIPËRISË

Nr. 94 prot.  
Tiranë, më 15.04. 2022

Nr. extra prot.  
Tiranë, më 15.04. 2022

***MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI***

***NDËRMJET***

***QENDRËS SË PARANDALIMIT TË KRIMEVE TË TË MITURVE DHE TË  
RINJVE (QPKMR)***

***DHE***

***SHOQATËS SË AVOKATËVE PENALISTË TË SHQIPËRISË***

***“Për***

***ofrimin e shërbimeve në kuadër të rehabilitimit dhe riintegritit të të miturve dhe  
të rinjve në konflikt me ligjin”***

Sot më datë, \_\_\_\_/\_\_\_\_/2022, lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Palëve:

**Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve** me adresë: Blvd. “Zog I”, përfaqësuar nga **Znj. Klaudia Hasanllari** këtu e në vijim “**Qendra**”.

*dhe*

**Shoqata e Avokatëve Penalistë të Shqipërisë**, me adresë: rruga “Reshit Petrela” përballë Gjykatës për Krimet e Rënda 1001, përfaqësuar nga Avokat **Saimir Vishaj**, këtu e në vijim “**Shoqata**”.

Duke qenë se Palët:

*Vlerësojnë* rëndësinë e përmirësimit të administrimit të drejtësisë penale për të miturit në konflikt me ligjin në kuadër të forcimit të shtetit të së drejtës dhe përmirësimit të respektimit të drejtave të njeriut;

*Konsiderojnë* se një ndër objektivat kyç në ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve në nivel qendror dhe vendor është efikasiteti në ofrimin e shërbimeve me qëllim asistimin dhe trajnimin e punonjësve në Institucionet e Përkujdesjes Shoqërore për të miturit;

*Marrin në konsideratë* politikat e ndjekura dhe masat e ndërmarra në nivel legjislativ për të mbrojtur dhe garantuar të drejtat e të miturve në konflikt me ligjin dhe kërkesat për implementimin e suksesshëm të tyre;

*Synojnë* implementimin efektiv të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit nëpërmjet mbrojtjes së interesit më të lartë të të miturve, integrimin social dhe rehabilitimin e të miturve në konflikt me ligjin, viktimave dhe dëshmitarëve;

*Afirmojnë* vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të kësaj marrëveshje për të përmbushur angazhimet e ndërmarra në kuadër institucional;

*Kanë rënë dakord* të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, në vijim e quajtur *Marrëveshje*.

## Neni 1

### **Qëllimi**

Kjo marrëveshje ka për qëllim përcaktimin e mënyrave të bashkëpunimit midis Shoqatës së Avokatëve Penalistë të Shqipërisë dhe Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve për të siguruar përkrahje juridike e sociale për të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin.

## Neni 2

### **Baza ligjore**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi bazohet në ligjin nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, në ligjin nr. 18/2017, “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen dhe e Fëmijës”, VKM nr.148, datë 13.03.2018 “Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave këshillimorë e koordinues institucionalë, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave kombëtare e vendore, si dhe për shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës”, si dhe në VKM nr. 314, datë 15.05.2019, “Për organizimin, funksionimin, si dhe përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve”.

## Neni 3

### **Roli dhe përgjegjësitë e palëve**

1. Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve merr përsipër:
  - a) të caktojë personin përgjegjës (mbikëqyrës) që do të ndjekë ecurinë e trajtimit të rasteve të të miturve dhe të rinjve në konflikt me ligjin;
  - b) të përcaktojë në bashkëpunim me personin përgjegjës që drejton shoqatën kalendarin e monitorimit të rasteve;
  - c) të hartojë dhe të dërgojë një Letër Referencë për të miturit që kanë përfunduar dënimin ose janë duke e vuajtur dënimin, në të cilën evidentohet nevoja për asistencë juridike dhe shërbime të tjera që shoqata disponon, si dhe të komunikojë me personin përgjegjës nga Shoqata për ndjekjen e rasteve;

- d) të marrë pjesë në takime dhe tryeza të përbashkëta që zhvillohen nga shoqata, në kuadër të rritjes së kapaciteteve në lidhje me zbatimin e legjislacionit për masat alternative.

2. Shoqata e Avokatëve Penalistë të Shqipërisë, merr përsipër:

- a) të organizojë trajnime të përbashkëta me qëllim forcimin e kapaciteteve profesionale të strukturave të shërbimeve mbështetëse;
- b) të sigurojë punonjës të specializuar me profil juridik dhe me profil social për të ndjekur dhe trajtuar të miturit, në rastet kur kërkohet nga Qendra;
- c) të sigurojë bashkëpunimin e punonjësit kompetent të shoqatës me Qendrën;
- d) të kontribuojë dhe të bashkëpunojë në zbatimin e programeve dhe aktiviteteve të ndryshme organizuar për këshillimin, përmirësimin, ndërmjetësimin dhe programe të tjera që lidhen me ripërfshirjen e të miturve dhe të rinjve në kryerjen e veprave penale, si dhe në asistimin nga ana ligjore për këtë kategori.

Neni 4

**Kohëzgjatja**

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë 1 (një) vjeçare nga dita e nënshkrimit dhe do të jetë efektive përgjatë këtij afati.

Neni 5

**Konfidencialiteti**

Palët në dijeni të përgjegjësishë së tyre ligjore, zotohen të respektojnë dhe të ruajnë etikën profesionale dhe konfidencialitetin e informacionit për secilin nga rastet objekt të bashkëpunimit mes tyre.

Neni 6

**Personat e kontaktit**

1. Secila nga palët përcakton një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet, qofshin verbale apo të shkruara, si elektronike ashtu dhe të shtypura në letër. Në çastin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, personat e kontaktit janë si vijon:

**Për Qendrën:**

**Znj. Klaudia Hasanllari**

Drejtor i Qendrës së Parandalimit të Krimeve të Miturve dhe të Rinjve

Adresa: Rruga “Bulevardi Zog i I-rë”, Tiranë

E-mail: [klaudia.hasanllari@drejtesia.gov.al](mailto:klaudia.hasanllari@drejtesia.gov.al)

Kontakt: 0688751513

**Për Shoqatën:**

**Z. Saimir Vishaj**

Kryetar i Shoqatës së Avokatëve Penalistë Shqiptarë

Adresa: Rruga “Reshit Petrela” përballë Gjykatës për Krime e Rënda  
1001

E-mail: [avokatetpenaliste@gmail.com](mailto:avokatetpenaliste@gmail.com)

Kontakt: 0682036896

2. Personat e caktuar në pikën 1 të këtij neni do të jenë përgjegjës për saktësinë e protokolleve, proces-verbaleve, listave dhe çdo dokumenti shoqëruar që do të dalë në zbatim të Marrëveshjes.
3. Në rast të ndryshimit të njërit prej personave të caktuar në pikën 1 të këtij neni, Pala e cila përfaqësohet prej këtij personi do të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda 1 (një) jave kalendarike nga data e ndryshimit, të dhënat e personit të ri të kontaktit.

Neni 7

**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Secila nga palët mund të përfundojë këtë marrëveshje përpara afatit të përcaktuar në nenin 4, duke njoftuar palën tjetër me shkrim, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të marrëdhënieve të marrëveshjes, duke dhënë sqarime të hollësishme dhe të qëndrueshme mbi këtë ndërprerje.
2. Për çdo rast, pavarësisht mënyrës së përfundimit, secila nga palët do të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja deri në çastin e ndërprerjes së marrëdhënieve.

Neni 8

**Hyrja në fuqi**

Marrëveshja hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit të saj.

Neni 9

**Dispozita të fundit**

1. Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje të barasvlershme, nga 2 (dy) kopje për secilën palë, të firmosura nga titullarët dhe të vulosura me vulat zyrtare të institucioneve palë.
2. Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.

**PËR**

**QENDRËN E PARANDALIMIT  
TË KRIMEVE TË TË MITURVE  
DHE TË RINJVE (QPKMR)**

**DREJTOR**

**KLAUDIA HASANLLARI**



**PËR**

**SHOQATËN E AVOKATËVE  
PENALISTË TË SHQIPËRISË**

**KRYETAR**

**SAIMIR VISHAJ**

